

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses Luljete Shabani, me Praktikanten Lindita Aliti në lëndën penale kundër të pandehurit A. M. nga ... për shkak të veprës penale, **Vjedhja nga neni 325, par. 2** të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP. II. Nr. 1930/2016, të datës 24.10.2016, më datën 09.11.2016, mori këtë :

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit :

A. R.M., i lindur më ... në Gj... ku edhe jeton, në rr. "...", nr. 34, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse, më datë 11.10.2016, rreth orës 17.50 min. në rr. "... " në Gj..., me qëllim të përvehtësimit të kundërligjshëm pasuror për vete, ka kryer vjedhje në dëm të të dëmtuarës-librarisë "...", ashtu që, në kohën kur shitësi J. N. ka dalur jashtë librarisë, i pandehuri ka hyrë dhe nga arka ka marrë para në vlerë prej 20 €, me çka, të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në vlerën e caktuar,

- me çka ka kryer veprën penale, **Vjedhja, nga neni 325, par. 2 të KPRK-së.**

Andaj, në bazë të dispozitës së lartëcekur ligjore dhe neneve 3, 34, 35, 36, 39 dhe 64 të KPK, si dhe nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurit i shqipton

DËNIM ME GJOBË,

Ashtu që të pandehurit A. M., i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej **150 € (njëqindpesëdhjetë) €**, të cilin dënim i pandehuri do t'a paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri refuzon që të paguaj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse i pandehuri nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Obligohet i pandehuri që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej **20 €**, në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest civil.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën PP. II. nr. 1930/2016, të datës 24.10.2016, ndaj të pandehurit A.M., për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 325, par.2, të KPRK. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurit ka kërkuar që t'i shqiptohet dënimi me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjykatësja, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurit A. M. dhe t'i shqiptojë dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Në bazë të deklaratës së të pandehurit e dhënë në polici, ku ai e ka pranuar veprën penale që i vihet në barrë, deklaratës së dëshmitarit, raportit të oficerit policor, si dhe shkresave tjera të lëndës, gjykatësja konstatoi se i pandehuri A. M. ka kryer veprën penale Vjedhja, nga neni 325, paragrafi 2 të KPRK-së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e PPK dhe ndaj të pandehurit, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënimi me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tij, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 34 të KPK.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike dhe shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 495, paragrafi 1 lidhur me nenin 378, paragrafi 6, lidhur me par. 1 të KPP.

Nga të cekurat më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN më 09.11.2016

**Sek. juridike ,
Resmije Krasniqi**

**Gjykatësja,
Luljete Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të të njejtit. I pandehuri njoftohet se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtimi nuk paraqitet, urdhëri ndëshkimor merr formë të prerë dhe do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.*